

Sot, me daten 16.11. 1994, ne Tiranë, une, i quajtura AGIM BARAJ i biri i Halimit, dhe i Haties lindur me 1968, banues ne rrethin e Ballsh, rruga "Ishati Drenovë", pall. -, shk. -, ap. -, me deshiren time, mora vendimin qe te krijoj Shoqerine Tregtare me emrin "ALBA" te import-eksportit, me pergjegjesi te kufizuar (shpk), qendra e se ciles aktualisht do te jete ne adresen e sipershenuar, por me kalimin e kohes mund te ndryshoje seline e saj.

Veprimtaria e Shoqerise qe po krijoj do te konsistoje ne fushen e Projektimit dhe të zbatimeve për punime murature, betoni, b/armeje të zakonshme, punime shembjesh, prodhim materialesh ndërtimi, Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore etj. dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to, Tregëtim materialesh ndërtimi, mallrash industriale (të import-eksportit), me shumicë e me pakicë brenda dhe jashtë vendit.

Kete aktivitet do ta ushtroj aktualisht si ortak dhe administrator i vetem, pa pjesemarres te tjere sot per sot, me nje kapital fillestar 100.000 ( njëqindmijë ) leke.

Kete akt themelimi e mbeshtes ne ligjet nr.7512, date 10.08.1991 dhe nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe, mbasi te regjistrohem si person juridik i kesaj Shoqerie Prodhuese e Tregtare ne organet kompetente (ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes dhe perfundimisht ne Zyren perkatese tatimore), do te zhvilloj veprimtarine private sipas objektit te shenuar ne statut dhe te percaktuar ne vendimin perkates te Gjykates si person juridik.

Ne aktivitetin tim ne kete Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (shpk) do t'i permbahem statutit te hartuar per kete qellim dhe do te respektoj si dispozitat ligjore qe jane ne fuqi dhe ato qe do te dalin me vone per veprimtarine private te shoqerive prodhuese e tregtare.

Ky akt themelimi u redaktua ne tri kopje, nga te cilat njerën kopje e mban Gjykata e Rrethit te Tiranes, nje kopje do te dorezohet ne Zyren perkatese te Tatimeve dhe kopja e fundit do te mbahet nga une, pronari e themeluesi i kesaj Shoqerie, se bashku me aktet e tjera.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga une, themeluesi i kesaj Shoqerie (shpk).

ORTAK I VETEM I THEMELIMIT TE  
SHOQERISE PRIVATE TREGTARE" ALBA "  
( AGIM BARAJ )

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
N O T E R I A


VERTETIM

Nr. 54/4 rep.  
Nr. 2653/11 kol

Sot, me daten 16.11. 1994 (nentedhjetekater) u paraqit personalisht ne Zyren e Noterise ne Tirane shtetasi Agim Baraj, ortak i vetem i themelimit te Shoqerise Private Tregtare" ALBA " me seli ne Ballsh, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin dhe gjeneralitetet e te cilit u sigurova nga leternjoftimi i tij personal, i cili me deklaroi se statutin dhe aktin e themelimit te kesaj Shoqerie i ka hartuar me deshiren e vullnetin e tij te lire dhe i nenshkroi para meje. Une, mbasi i gjeta ne rregull, i vertetoj sipas ligjes.

N O T E R E:

(Shpresa Spahiu)



## S T A T U T I

### I SHOQERISE PRIVATE " ALBA " ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR (SHPK)

Ne mbeshtetje te ligjit nr.7512, date 10.08.1991 dhe te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", une, i quajhuri AGIM HALIM BARAJ, si themelues i Shoqerise Private e Tregtare "ALBA" (shpk), sot, me daten 16.11.1994, duke pasur edhe zotesine e plote juridike per te vepruar, shpall persa vijon:

"Formimin e Shoqerise Private Tregtare "ALBA" (shpk) me seli ne Balish".

### F O R M I M I

#### Neni 1

Formohet Shoqeria Private Tregtare "ALBA" (shpk) me themelues z. Agim Baraj, i biri i Halimit dhe i Haties, lindur me 1968, banues ne qytetin e Balishit (ishati Drenovë).

#### Qendra e Shoqerise

#### Neni 2

Qendra e Shoqerise Tregtare Private "ALBA" do te jete ne qytetin e Balishit, por me kalimin e kohes, mund te nderroje vendqendrimin brenda qytetit te Balishit dhe te hape dege te reja ne qytete te tjera te Shqiperise.

#### Kohezqjatja e veprimtarise se Shoqerise

#### Neni 3

Kohezqjatja e veprimtarise se Shoqerise Tregtare Private "ALBA" eshte e pakufizuar dhe mund te zgjase 10 vjet, por edhe mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çdo shkak.

#### Objekti i veprimtarise se Shoqerise

#### Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise "ALBA" eshte:  
Projektme dhe zbatime për punime muratore, betoni, b/armeje të zakonsame, punime shembjesa, prodhim materialeshu ndërtimi. Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore etj. dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to. Tregëtim materialesh ndërtimi, mallrash industriale (të import-eksportit), me shumicë e me pakicë, brenda dhe jashtë vendit.

## Kapitali i Shoqerise



### Neni 5

Kapitali i Shoqerise si fillim eshte 100.000 leke, kontribut i vete themeluesit te Shoqerise, z. Agim Baraj dhe vetem ai eshte poseduesi ketij kapitali. Kapitali i kesaj Shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (shpk) do te shtohet ose do te pakesohet me kalimin e kohes, sipas vendimeve qe do te marre themeluesi i saj.

## Drejtimi dhe administrimi

### Neni 6

Shoqeria private "ALBA" deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut dhe ne ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo eshte krijuar dhe do te veproje ne perputhje me ligjin nr. 7512, date 10.08.1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe te privatizimit", te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe te ligjeve te tjera qe do te shpallen ne te ardhmen per kete qellim. Shoqeria Private "ALBA" vepron si person juridik qe nga data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit te Tiranës, ndersa do te ushtroje veprimtarine e saj ekonomike me marrjen e lejes se ushtrimit te veprimtarise private nga Zyra perkatese e tatimeve.

### Neni 7

Shoqeria Private ka vulen e saj me mbishkrimin:  
SHOQERIA PRIVATE "ALBA" (SHPK) - BALLSH (ALBANIA)

### Neni 8

Shoqeria Private "ALBA" vepron ne regjim te punes private dhe merr persiper te drejta dhe detyrime. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore dhe jashtekontraktore brenda kapitalit te saj te fituar.

### Neni 9

Shoqeria Private "ALBA" eshte e krijuar si prone e vetme e z. Agim Baraj. Vendimet qe merren nga themel. aktual si dhe ato vendime qe merren ne rastet e bashkepunitimit te aktiviteteteve te kesaj Shoqerie me ortake te tjere, si bashkepronare, ne zbatim te ligjeve ne fuqi, sipas ketij statuti, jane te detyrueshme per te gjithë administratoret dhe te punesuarit ne kete Shoqeri.

Neni 10

Administratori i kesaj Shoqerise, i cili eshte njekohe-  
sisht edhe themel. i saj, z. Agim Baraj, sipas  
nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise ekonomike dhe  
asaj financiare te Shoqerise, emeron administratore ne qender dhe  
ne deget e Shoqerise si dhe puneson punetore sipas nenit 4 te  
ketij statuti, duke respektuar ligjin mbi maredheniet e punes.

Neni 11

Administratori i Shoqerise dhe , me autorizimin e tij,  
administratoret e emeruar prej tij, jane te veshur me te gjitha  
fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te  
Shoqerise pa asnje lloj perjashtimi dhe i kane mundesite te  
kryejne te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per arritjen  
e qellimit te Shoqerise. Ata kane te drejte, midis te tjerash,  
te blejne , te shesin, te kembejne pasuri, lende te para, qe  
lidhen me veprimtarine e Shoqerise, te lidhen me shoqerite e  
tjera, qofshin te vendit apo te huaja, duke siguruar pjesemarrjen  
per qellimin e veprimtarise se siperpermendur ne nenin 4 te ketij  
statuti si dhe te kryejne çdo lloj veprimi prane te gjithë  
institucioneve bankare e fianciare, hipotekore dhe te çdo lloji  
tjeter. Ne keto raste administratoret e ngarkuar nga pronari i  
Shoqerise kane per detyre ta njoftojne ate dhe t'i japin llogari  
atij.

Neni 12

Themeluesi Shoqerise cakton administratore, te cilet,  
ne aktin e emerimit marrin te drejtat, detyrat dhe masen e pages.  
Po keshtu vepron edhe me punetoret e punesuar, me te cilet lidh  
kon-traten e punesimit ne perputhje me ligjin "Mbi lidhjen e  
kontrates individuale apo kolektive". Ne kontrate percaktohen  
kushtet e punes per punetoret e administratoret e punesuar.  
Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te  
punesimit mbi "Marrredheniet e Punes" dhe te sigurimit shoqeror  
per ta, me forma stimuluese per punen e tyre, ndersa te gjithë  
te punesuarit jane te detyruar te pranojne statutin e Shoqerise  
dhe ta respektojne ate me rigorozitet.

Neni 13

Administratoret nuk mund te marrin cilesine e ortakut  
ne Shoqerine Private "ALBA" dhe as te  
ushtrojne aktivitetet kontraktuese te çdo lloji per llogari te  
tyre ose te te treteve, perveç rasteve te autorizuar nga pronari  
i Shoqerise. Per çdo shkelje administratoret ose te punesuarit  
largohen nga puna dhe pergjigjen per çdo demtim.

Neni 14

Te gjitha shpenzimet e nevojshme per mbajtjen e te  
punesuarve perballohen nga vete Shoqeria "ALBA"

## Perfaqesimi i Shoqerise

Neni 15



Perfaqesimi i Shoqerise do te behet nga i saj dhe prej administratoreve eventuale te caktuar prej tij si ne qender, ku ajo ushtron veprimtarine e saj, ashtu edhe ne deget ne rast te krijimit te tyre, sipas ketij statuti. Me vendim te pronarit, administratorët edhe mund te zevendesohen. Ata zbatojne te gjitha vendimet e themeluesit ne kuadrin e detyrave te caktuara atyre ne aktin e emerimit ose me rregullore te veçante.

Themeluesi dhe administratorët e Shoqerise kane te drejte ta perfaqesojne Shoqerine "ALBA" ne organet gjyqesore, ne gjykime te tjera si dhe para institucioneve shteterore si dhe te caktojne avokate mbrojtës per çështjet ne gjykim.

## Sekreti i Punes

Neni 16

Te gjithë te emeruarit ne Shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se Shoqerise. Sekret pune paraqesin shkresat, materialet, aktet, te cilat, me ligj te veçante, dhe me vendime te nxjerra nga themeluesi perbejne sekrete pune. Te dhenat informative, bilancet, plani si edhe informacionet mbi politiken ekonomike te Shoqerise, qe u jepen organeve perkatese sipas ligjeve, nenshkruhen nga themeluesi ortaku i vetem i Shoqerise.

Detyra mbi ruajtjen e sekretit te punes nga te punesuarit vazhdon edhe pas largimit te tyre nga Shoqeria.

## Bilanci dhe te Ardhurat

Neni 17

Veprimet ekonomike dhe financiare te Shoqerise "ALBA" mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti, perveç urdhrave te veçante qe jep themeluesi i Shoqerise per kete qellim. Ne fund te periudhes ushtrimore (mujore dhe tremujore) Shoqeria dhe admini-stratoret nxjerrin bilancin kontabel te Shoqerise me rezultatin ekonomik FITIM dhe HUMBJE, bazuar ne ligjet ne fuqi dhe ne rregullat e mbajtjes se kontabilitetit, qe kerkohen per personat juridike private dhe shoqerite private nga organet kompetente financiare. Bilanci kontabel i Shoqerise miratohet dhe nenshkruhet nga themeluesi i saj.

Neni 18

Te ardhurat netto, pas veçimit te fondeve te akumulimit dhe te pageses se detyrimeve fiskale, i mbeten per perdorim ortaku i vetem te Shoqerise ose bashkepronareve, nese do te kete te tille. Eshte e drejta e themeluesit qe te vendose per perdorimin e fondeve nga te ardhurat netto te krijuara si dhe per perdorimin e tyre. Pjesa e fitimit netto, qe i perket themeluesit shqiptar apo anetareve te Shoqerise, mund te transferohet lirisht jashte shtetit shqiptar pa kufizim, bazuar ne ligjin nr.7594, date 4.08.1992.



Shperndarja e Shoqerise

Neni 19

Shperndarja e Shoqerise mund te behet ne çdo kohe dhe per çdo shkak. Themelusi i Shoqerise vendos mbi menyren e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore, duke iu percaktuar dety-rat. Administratoret jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se Shoqerise, perderisa t'u dorezohet ajo personave fizike apo juri-dike, duke likuiduar, ne rradhe te pare, detyrimet ndaj personave te trete qe mund te kete Shoqeria.

Neni 20

Shoqeria Private "ALBA" ka numrin e llogarise rrjedhese te regjistruar ne Banken e Shtetit Shqiptar ne Bellisi.

Dispozita te pergjithshme

Neni 21

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet çdo ligji te veçante perkates dhe legjislacionit shqiptar, veçanerisht ligjit per shoqerite tregtare nr. 7638, date 19.11.1992 si dhe ligjeve te tjere qe do te shpallen per kete qellim.

Neni 22

Ky statut redaktohet ne disa kopje, nga te cilat njerën kopje e mban Zyra e Noterise, qe kryen vertetimin noterial, nje kopje e mban Gjykata e Rrethit te Tiranes, qe kryen regjistrimin e Shoqerise si person juridik, nje kopje i dorezohet Zyres perkatese Tatimore bashke me dokumentet e tjera respektive ndersa kopja e fundit mbetet si pjese e dokumentacionit te Shoqerise" "ALBA".

Statuti nenshkruhet rregullisht nga themel. i kesaj Shoqerie.

THEMELUESI DHE ADMINISTRATORI I  
SHOQERISE PRIVATE" ALBA "

( AGIM BARAJ )

Tirane, me 16.11.1994.

